



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

KËSHILLI KONSULTATIV
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 483 prot

Tiranë, më 21.12. 2023.

VENDIM

Nr. 6 datë 21.12. 2023

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE
VENDORE TË DATËS 4/12/2023

Këshilli Konsultativ bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe në VKM Nr.910, datë 21.12.2016, “Për çështjet objekt konsultimi dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme, të mbledhjes së datës 4.12.2023 vendosi:

1. Për projektligjin “**Për buxhetin e vitit 2024**”, propozuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
 - Të akordohen fonde të nevojshme në fushën e mbrojtjes sociale (fonde të planifikuara vetëm për 7 bashki);
 - Të aplikohet buxheti i përgjithshëm gjinor në nivel qendoror dhe vendor për përmirësimin e gjendjes së barazisë gjinore;
 - Aneksi 2, të shtohet dhe përfshirja e pushtetit vendor ose e Shoqatës për Autonominë Vendore;
 - Të informohen bashkitë nga përfaqësuesit e tyre në Fondin Shqiptar të Zhvillimit mbi ndarjen e fondeve;

- Të përfshihet përformaanca në ndarjen e buxhetit;
 - Të futet në formulë dhe prodhimi i brendshëm bruto.
2. Për projektvendimin **“Për procedurën e paraqitjes së kërkesës, afatet kohore, përgjegjësitë dhe rolet e përdoruesve të sistemit”**, propozuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Kreu 1, pika 3, të shtohet dhe dokumentacioni i nevojshëm për fazën 1 referuar nenit 8 të VKM-së nr. 384, datë 12.06.2019;
 - Të përgatitet një manual përdorimi të sistemit e-albania për aplikimin në fazën e parë dhe në fazën e dytë për personat që do të hasin vështirësi në aplikim.
3. Për projektligjin **“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar**, propozuar nga Ministria e Brendshme, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Të përcaktohen kostot financiare për shërbimin dhe të shoqërohen me fondet e këruara nga vetëqeverisja vendore.
4. Për projektvendimin **“Për miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit dhe funksionimit, programet dhe financimin e shërbimit të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin”**, propozuar nga Ministria e Drejtësisë, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Të trajtohen raportet mbi kapacitetet për këtë shërbim në këshillin bashkiak para se të dërgohen në ministrinë përkatëse;
 - Pika 4, nen 20, të përcaktojë qartësisht mënyrën e financimit të personave juridik jopublik të licensuar;
 - Të përcaktohen kostot financiare për shërbimin dhe të shoqërohen me fondet e këruara nga vetëqeverisja vendore.
5. Për projektvendimin **“Për miratimin e dokumentit të politikave të përfshirjes sociale”**, propozuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, anëtarët e Këshillit Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Të përfshihen njësitë e vetëqeverisjes vendore që sigurojnë të dhëna lidhur me treguesit në nivelin vendor.
6. Për projektligjin **“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.93/2015, “Për turizmin” të ndryshuar**, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, anëtarët e Këshillit u

shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

- Neni 31, pika 4, të përcaktohet procedura nga Këshilli i Ministrave për financimin e projekteve që do të ndiqet për dy shkronjat e tjera 1) (a) dhe (c);
 - Neni 19, të rishikohen detyrat dhe përgjegjësitë e NJVV-ve në fushën e turizmit.
7. Për projektvendimin **“Për miratimin e rregullave për përfitimet nga shfrytëzimi i shërbimeve të ekosistemit pyjor, kompensimit dhe pagesat”**, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, anëtarët e Këshillit mbështetur në mendimet e tyre, u shprehën parimisht dakord.
8. Për projektvendimin **“Për miratimin e rregullave për projektet që duhen t'i nënshtrohen oponencës teknike dhe procedurat që ndiqen”**, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Neni 15 parashikon që projekti që i nënshtrohet oponencës duhet të jetë konfirmuar nga autoriteti përgjegjës për vendimmarjen për leje ndërtimi, krijon konfuzion me nenet e tjera ku parashikohet se oponanca është kusht për dhëni e lejes së ndërtimit.
 - Neni 17 dhe neni 17/1, parashikon kriteret e specialistëve që do kryejnë oponencën teknike, ku termi “të licensuar”, të zëvëndësohet me termin “profesor”, me 15 vite eksperiencë në fushën përkatëse.
9. Për projektudhëzimin **“Për shërbimet publike të transportit rrugor të udhëtarëve”**, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Të specifikohen arsyet e mundshme për ndërprerjen, shkeljet dhe penalitetet që mund të aplikohen në rastin e kushteve të kontratës.
10. Për projektudhëzimin **“Për miratimin e formatit të kérkesës, llojet e dokumentave që paraqiten për shpalljen ose njohjen e statusit "Dëshmor i Atdheut" si dhe kushtet teknike të plotësimit të tyre”**, propozuar nga Ministria e Mbrojtjes, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Neni 5/2, “kérkesa për shpalljen “Dëshmor i Atdheut” të një personi.....” mund t'i drejtohet Ministrit, të zëvëndësohet/hiqet termi “mund” me qëllim parashikimin e detyrimeve dhe procedurave të qarta;
 - Neni 6/2 termi “etj” lë të hapur kategorinë e subjekteve kérkuese;
 - Neni 2, shkronja “b” të përcaktohen rastet kur e shpall Këshilli Bashkiak/Këshilli i Qarkut/ Prefekti;
 - Kreu VI neni 16, të përcaktohet nëse propozimi dërgohet nga të gjithë apo njëri prej tyre;
 - Neni 2, shkronja “e”, të shtohet dhe një grupim qytetarësh prej 5000 vetash;

- Neni 15, pika 7, të parashikohet rrathi i subjekteve për të ankimuar vendimin e Këshillit të Qarkut/ Bashkisë/Prefekturave.

Z. Arbjan MAZNIKU
Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor
Bashkëkryetar

Z. Aldrin DALIPI
Kryetar i Shoqatës së Këshillit
të Qarqeve të Shqipërisë
Bashkëkryetar